



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr. 07, datë 26.07.2018

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS:  
“NDËRTIMI I URËS SË DROJËS, ME VENDNDODHJE MBI LUMIN E DROJËS,  
THUMANË, BASHKIA KRUJË DHE BASHKIA KURBIN”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Autoritetit Rrugor Shqiptar, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës: “Ndërtimi i Urës së Drojës, me vendndodhje mbi lumin e Drojës, Thumanë, Bashkia Krujë dhe Bashkia Kurbin”, me subjekt zhvillues Autoritetin Rrugor Shqiptar.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës përkatëse të taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Bashkive Krujë dhe Kurbin.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

